



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2017
Nr. ref.:RK 1065/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI26/16

Parashtrues

Januz Fazliu

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Januz Fazliu nga Prishtina (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin [AC-I-14-0311-A0001-A0023] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), të 15 korrikut 2015. Aktgjykimi i është dorëzuar parashtruesit më 17 tetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur të drejtat e parashtruesit nga neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], neni 24 [Barazia para Ligjit] në lidhje me nenin 3 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 shkurt 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 14 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 15 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 2 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore “Voçar” (në tekstin e mëtejme: NSH “Voçar”) në periudhën nga 1 tetori 1984 deri më 1 janar 1994.
10. Më 1 janar 1994, menaxhmenti i NSH “Voçar” me Aktvendimin [nr. 31/94] e dërgoi parashtruesin në pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej 24 muaj.

11. Gjatë vitit 2007, parashtruesi paraqiti padi kundër NSH “Voçar” në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit të të paditurit [nr. 31/94], të 1 janarit 1994 dhe pagesën e kompensimit për fitimin e humbur.
12. Më 2 maj 2007, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) filloi procesin e privatizimit të NSH “Voçar”.
13. Më 22 mars 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin [Cl. nr. 464/07], e ndërpreu procedurën lidhur me këtë çështje, në bazë të kërkesës së AKP-së dhe nenit 277 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sepse i padituri është NSH “Voçar” në falimentim kundër të cilit ka filluar procedura e likuidimit.
14. Më 12 prill 2011, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale për ndërprerjen e procedurës.
15. Më 4 korrik 2011, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [Ac. nr. 2880/2012] me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, me arsyetim se: *“Gjykata e Apelit një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e pranon, për faktin se AKP-ja ka bërë një njoftim publik, si dhe me shkresën e saj të fundit të datës 10.02.2011 gjithashtu ka njoftuar se ndërmarrja e paditur është në procesin e likuidimit, duke kërkuar ndërprerjen e të gjitha procedurave gjyqësore kundër kësaj ndërmarrje”*.
16. Më 21 korrik 2011, AKP publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të cilët kishin fituar të drejtën për marrjen e një pjese nga 20% të të ardhurave të realizuara nga privatizimi i NSH “Voçar”, në të cilën parashtruesi i kërkesës nuk ishte i përfshirë.
17. Më 11 gusht 2011, parashtruesi paraqiti ankesë në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar) pas skadimit të afatit ligjor, duke pretenduar se ai ka të drejtë në 20% të të ardhurave nga privatizimi.
18. Më 20 shtator 2011, AKP ka dërguar komentet e saj ndaj ankesës së parashtruesit në të cilat theksoi se ankuesi (parashtruesi) nuk i plotëson kushtet sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut, për t’u kualifikuar për realizimin e të drejtës për shpërndarje të 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Voçar”, sepse nuk ka ofruar prova të vlefshme për të justifikuar kërkesën e tij.
19. Më 29 shtator 2014, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar) nxori Aktgjykimin [SCEL-11-0045], me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit me arsyetim:

“Gjykata në bazë të shkresave të lëndës ka vërtetuar se ankuesi, nuk ka ofruar asnjë provë materiale për vërtetimin e të cekurave në ankesë. Ankuesi nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së

UNMIK-ut 2003/13 (e plotësuar dhe e ndryshuar). Për këto arsye ankesa refuzohet si e papranueshme”.

20. Më 27 tetor 2014, parashtruesi paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjyqimit të Kolegjit të Specializuar duke pretenduar “*se ai e humbi punën për shkak të masave të përkohshme të sistemit politik gjatë viteve të 90-dhjeta”.*
21. Më 15 korrik 2015, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin [AC-I-14-0311-A0001-A0023], me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit. Në arsyetimin e Aktgjyqimit thuhet:

“Parashtruesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi materiale për të dëshmuar marrëdhënien e tij të punës në këtë NSH. Kolegji i Specializuar ka konstatuar se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë materiale për t’i provuar pretendimet ankimore, andaj ishte refuzuar ankesa si e pabazuar. Kolegji i Apelit konstaton se vendimi i Kolegjit të Specializuar lidhur me këtë ankues është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi materiale as në procedurën e ankesës, për t’i mbështetur pretendimet e tij. Për këto arsye, ankesa refuzohet si e pabazuar”.

Ligji relevant

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13: “*Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se 3 (tri) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilin pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi në kërkesë theksoi se “*aktgjykimin e Kolegjit të Apelit e konsideron të pabazuar për shkak se e përjashton nga lista përfundimtare për përfitimin e 20% nga privatizimi i NSH “Voçar”.*
23. Parashtruesi, më tej, thekson “*se me Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-14-0311-A0001-A0023, të dt. 15.07.2015, në pjesën që ka të bëjë me parashtruesin, janë bërë shkeljet e dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe atë të: nenit 21, 22 lidhur me nenin 53 dhe nenin 54; nenit 24 lidhur me nenin 3, dhe nenit 31, për çka në atë pjesë i njëjti shfuqizohet”.*
24. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë: “*që Gjykata të detyrojë AKP-në ta përfshijë atë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta të përfitimit të së drejtës së pjesëmarrjes në 20% nga të hyrat nga procesi i privatizimit”.*

Pranueshmëria e kërkesës

25. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ankesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

28. Lidhur me atë që u tha më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesi e dorëzoi kërkesën si individ dhe në cilësinë e palës së autorizuar dhe se ka treguar për shkeljet e mundshme kushtetuese, kërkesa është parashtruar në pajtim me afatet e përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Prandaj, Gjykata konkludon se janë përmbushur të gjitha kriteret formale të pranueshmërisë për shqyrtimin e kërkesës.

29. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.

(2) “Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

30. Gjykata, duke analizuar pretendimet e parashtruesit nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, vërejtë se parashtruesi ka ndërtuar kërkesën e tij mbi pretendimet se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara në nenet 3, 21, 22, 24, si dhe 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës.

31. Gjykata para së gjithash deklaroi se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës:
- “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
32. Lidhur me këtë, duke vlerësuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit për shkeljen e nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, që kanë të bëjnë me diskriminimin, e që është në pajtim me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së, Gjykata i gjeti këto pretendime të pabazuara dhe atë për arsye se parashtruesi në kërkesën e parashtruar në Gjykatë theksoi se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me punëtorët e tjerë të NSH “Voćar”, pa e treguar më atë rast bazën e kësaj pabarazie.
33. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se diskriminimi ekziston nëse rezulton me një trajtim të ndryshëm të individëve në pozitat dhe situatat e ngjashme dhe nëse ky trajtim nuk ka justifikim objektiv ose të arsyeshëm. Për të qenë i justifikuar, trajtimi duhet të ndjek një qëllim legjitim, dhe duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit i cili duhet të realizohet (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Marckx kundër Belgjikës*, i 13 qershorit 1979, Aplikacioni nr. 6833/74).
34. Për këtë arsye është e nevojshme që në çdo rast të përcaktohet nëse parashtruesi është trajtuar ndryshe nga të tjerët në situatat e njëjta apo të ngjashme. Çdo trajtim i ndryshëm do të konsiderohet diskriminues në qoftë se nuk ka justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, gjegjësisht nëse nuk ndjek qëllimin legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme.
35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi, përveç pretendimeve të tij për shkeljen e të drejtave të cekura, nuk ka ofruar ndonjë argument i cili do të tregonte se ai ka qenë në ndonjë mënyrë i diskriminuar nga ana e gjykatave në procedurën në fjalë.
36. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit për shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, e që është në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, Gjykata gjithashtu i gjen këto pretendime të pabazuara, dhe atë për arsye se baza e ankesës së parashtruesit për shkeljet e pretenduara bazohet vetëm në faktin se ai nuk ka mundur para gjykatave të rregullta të realizojë të drejtën e tij për kompensim për të cilin ai mendon se ka të drejtë.
37. Gjykata vëren se gjykatat gjatë procedurës së rregullt i kanë marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e të dyja palëve në procedurë, edhe të parashtruesit si paditësit edhe të AKP-së si të paditurës me rastin e vërtetimit të bazueshmërisë së padisë, duke i vënë në pozitë të barabartë, duke iu mundësuar të paraqesin argumentet, dokumentacionin dhe provat e tyre, gjë që mund të shihet edhe në bazë të vendimeve të gjykatave të rregullta.

38. Gjykata, më tej, vëren se aktgjykimet e Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit janë të bazuara në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/ 13, në bazë të të cilit edhe kanë konkluduar se a) parashtruesi në kohën e privatizimit - likuidimit nuk ka qenë punëtor i NSH “Voçar”, b) nuk ka qenë në listën e pagave të NSH “Voçar” për jo më pak se 3 (tri) vite para privatizimit, dhe c) nuk ka arritur të ndërtojë rastin se diskualifikimi i tij është pasojë e diskriminimit.
39. Rrjedhimisht, Gjykata nga arsyetimi i dhënë nuk e sheh arbitraritetin; për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit i kanë marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet të cilat parashtruesi i ka theksuar gjatë procedurës së rregullt, dhe se me atë rast kanë dhënë konkluzione të qarta përse këto pretendime janë të pabazuara.
40. Gjykata thekson se parashtruesi, gjithashtu, pretendon se atij i është shkelur e drejta për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
41. Gjykata rikujton se nga neni 54 i Kushtetutës rrjedh se kushti për realizimin e së drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave është shkelja apo mohimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Nëse ka një shkelje të tillë, bartësi i së drejtës së shkelur ose të mohuar ka të drejtë pasuese në mjete efektive ligjore.
42. Gjykata, në fakt ka konkluduar se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është i pabazuar. Prandaj, nuk ka shkelje të të drejtave që çojnë në mbrojtjen gjyqësore. Rrjedhimisht, nuk ekziston objekti për shqyrtim kushtetues.
43. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk ka bazë për të shqyrtuar pranueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit për shkeljen e të drejtës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave në bazë të nenit 54 të Kushtetutës.
44. Si përmbledhje, Gjykata vlerëson se në procedurën e zbatuar nuk ka fakte apo rrethana të cilat në ndonjë mënyrë do të tregonin se parashtruesit në procedurën në Kolegjin e Apelit i janë shkelur të drejtat e njeriut dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
45. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e veta dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).
46. Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret sipas të cilave ankesa e parashtruesit të kërkesës do të shqyrtohej nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

47. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, më 2 maj 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

